**KONTRATË SHITJE KUOTE**

Sot më datën 20.12.2023 palet e meposhteme hartuan dhe nenshkruan kete kontrate si me poshte vijon:

**SHITESI: Z.Luçiano Koçeku,** lindur ne Bulqize, Diber, me date 25.01.1982, mbajtes i Leternjoftim ID me nr.028469300 dhe nr. Personal I20125095T, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar perfaqesuar me prokure te pergjithshme me Nr.973 rep/Nr.690Kol, date 24.06.2022 nga Znj. Marsida Cara, atësia Xhevat, shtetase Shqiptare, lindur në Mamurras dhe banuese në Tiranë, lindur më 01.04.1984, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajetese e Leternjoftim ID me Nr. Personal I45301092A. (referuar ketu dhe ne vijim si **"Shitesi"**).

dhe

**BLERESI: Shoqeria "Erald - G" shpk,** e regjistruar si person juridik prane QKB me date 16.07.2003, me NUIS K36306784K, me seli ne Ndertese private nr.61, Herbel, Peshkopi, perfaqesuar nga Z. Eraldo Islami, lindur me 23.09.1997 ne Peshkopi dhe banues ne Tirane, i identifikuar nepermjet Leternjoftim ID me nr.personal J70923059M, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar. (referuar ketu dhe ne vijim si **"Bleresi"**).

**MEQENESE EKZISTOJNE KUSHTET PARAPRAKE:**

- Shitesi, Z.Luçiano Koçeku eshte Ortak ne Shoqerine "LTD Co" shpk, rregjistruar ne rregjistrin tregtar me NUIS-i L42117004B, duke zoteruar 1 (nje) kuote me pjesemarrje 30 % te kapitalit te shoqerise
- Z.Luçiano Koçeku deshiron te shese dhe Shoqeria "Erald - G" shpk ne mbeshtetje te Vendim Asambleje, date 20.12.2023 ka shprehur vullnetin per blerjen e kesaj kuote me me pjesemarrje 30 % te kapitalit te Shoqerise "LTD Co" shpk
- Ne baze te Vendimit Nr.18, date 20.12.2023 te Mbledhjes se asamblese te Ortakeve te Shoqerise "LTD Co" Shpk, ortaku tjeter i Shoqerise "LTD Co" shpk, Z.Kujtim Shtufi ka dhene pelqimin per shitjen nga ana e ortakut Luçiano Koçeku te kuotes se zoteruar prej tij.

**PER SA ME SIPER**, si dhe duke marre parasysh marreveshjet reciproke te permbajtura ne kete akt, palet bien dakord si me poshte vijon:

**NENI 1**
**BLERJA DHE SHITJA E KUOTAVE**
Sipas dispozitave te kesaj Kontrate, **Shitesi** nepermjet ketij akti i shet **Bleresit dhe ky i fundit** blen 1 (nje) kuote e cila perfaqeson 30 % pjesmarrje ne kapitalin e shoqerise "LTD Co" shpk me NUIS L42117004B.
Kjo kuote blihet me cmimin e percaktuar ne nenin 2 te kesaj Kontrate.

**NENI 2**
**ÇMIMI I BLERJES DHE MENYRA E PAGESES**
**2.1**. Çmimi i blerjes se kuotes objekt i kesaj Kontrate qe Shitesi ia shet Bleresit eshte ne vleren prej 31,479,533 ALL (tridhjete e nje milion e katerqind e shtatedhjete e nente mije e peseqind e tridhjete e tre), me poshte i quajtur "Çmimi i Blerjes", vlere e cila do te likujdohet nepermjet llogarise bankare apo sipas marreveshjes ndermjet paleve nga Bleresi ne favor te Shitesit brenda 18 muajve nga nenshkrimi i kesaj kontrate shitje.

**2.2**. Referuar ligjit 129/2014 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 9901, date 14.4.2008, "Per shoqerite tregtare", palet jane dakord qe:
Me nenshkrimin e kesaj Kontrate Bleresi ka detyrimin te paguaje cmimin e kuotes objekt kontrate sipas percaktimeve ne nenin 2.1.

Kjo kontrate me nenshkrimin do te depozitohet prane QKB-se me qellim qe te behet kalimi i pronesise se kuotes ne emer te Bleresit.
Ne rast se Bleresi nuk likujdon cmimin objekt kontrate brenda afatit te percaktuar ne kete akt, atehere Shitesi rifiton te gjitha te drejtat duke e zhveshur Bleresin nga cdo e drejte pronesie.

**NENI 3**
**DEKLARATAT DHE GARANCITE**
**3.1**. Shitesi deklaron dhe garanton se:
**(i)** nenshkrimi dhe zbatimi e kesaj kontrate eshte autorizuar rregullisht
**(ii)** kjo kuote qe transferohet eshte e lire nga çdo barre apo ndonje pretendim tjeter ligjor nga pale te treta,
**(iii)** per shitjen e kuotes eshte mbajtur dhe mbledhja e asamblese se ortakeve ne te cilen ortaku Kujtim Shtufi, ka shprehur pelqimin per kete shitje.

**3.2**. Bleresi deklaron dhe garanton se:
**(i)** nenshkrimi dhe zbatimi i kesaj Kontrate eshte autorizuar rregullisht
**(ii)** ka te drejten, dhe nuk ka ndonje ndalim ligjor apo te ndonje lloji tjeter, per te nenshkruar dhe zbatuar kete Kontrate dhe detyrimet qe rrjedhin prej saj;
**(iii)** Bleresi ka nenshkruar dhe do te shlyeje ne menyre te plote kuoten, objekt i kesaj Kontrate ne llogarine bankare te Shitesit sipas percaktimeve dhe dakordesise ne kete akt;
**3.3** Kjo Kontrate neshkruhet rregullisht sot ne date 19.12.2023 dhe eshte shprehje e vullnetit te lire dhe perben nje detyrim ligjor, te vlefshem, te detyrueshem dhe te ekzekutueshem per Shitesin dhe Bleresin te cilet kane detyrimin qe menjehere ta depozitojne prane QKB-se me qellim reflektimin e te dhenave te pronesise mbi kuotat e shoqerise. Ne perfundim te transaksionit dhe me rregjistrimin e ketij akti jo noterial por te ligjshem dhe te vlefshem per palet, Z.Kujtim Shtufi do te jete ortak dhe zoterues i nje kuote me 70 % pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise, Shitesi Ortaku Luçiano Koçekudo largohet nga shoqeria dhe do te shtohet bleresi Shoqeria "Erald – G" shpk si ortake zoteruese i nje kuote me 30% pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise "LTD Co" shpk.

**NENI 4**
**TE NDRYSHME**
Kjo Kontrate, nenshkruhet ne 3 (tre) kopje te barasvlefshme ne gjuhen shqipe me nga 2 (dy) faqe secila dhe perben marreveshjen e plote midis paleve.

**NENI 5**
**LIGJI I ZBATUESHEM DHE MOSMARREVESHJET**
**5.1.** Problemet ne lidhje me çeshtje qe mund te lindin sipas kesaj Kontrate por qe nuk jane parashikuar ne te, do te zgjidhen ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise, te cilet do te jene te zbatueshme ne kete Kontrate.
**5.2**. Çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis paleve ketu ne lidhje me kete Kontrate dhe qe nuk do te zgjidhet nga negociatat midis tyre, do te jete objekt vendimi i Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.
**5.3**Kjo kontrate shitje kuotash, perpilohet ne baze te Vendimit Nr.18, date 20/12/2023 te Mbledhjes se Asamblese, bashkengjitur kesaj kontrate.

**PALET**

| **SHITESI** | **BLERESI** |
|---|---|
| **Luçiano Koçeku** | **"Erald – G" shpk** |
| Perfaqesuar nga Marsida Cara | Perfaqesuar nga Eraldo Islami |
| Marsida Cara | Eraldo Islami |

REPUBLIKA E SHQIPERISE PROJEKTIM MBIKQYRJE KOLAUDIM • ERALD-G • K36306784K TIRANE - ALBANIA

**VENDIMI NR.18**
**I MBLEDHJES SE ASAMBLESË SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË**
**"LTD CO" SHPK**

Sot, më 20.12.2023, shoqeria "LTD Co" shpk, një shoqëri e themeluar sipas ligjit shqiptar, me NUIS. L42117004B, therret mbledhjen e Asamblesë së Ortakëve në seline e shoqerise me adrese Rruga "Kajo Karafili", mbrapa ish lidhjes se shkrimtareve, Tiranë.

Mbledhja u thirr dhe u drejtua nga Administratori i shoqerise.

**Rendi i ditës:**

Miratimi i shitjes se nje Kuote me 30% pjesemarrje, kuote e cila zoterohet nga ortaku Luçiano Koçeku dhe miratimi i blerjes se kesaj kuote nga pala e trete Shoqeria "Erald – G" shpk

Prezent në mbledhje janë ortakët e shoqërisë:

Z. Kujtim Shtufi zotërues i nje kuote me 70 % pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise.

Z. Luciano Koceku zotërues i nje kuote me 30 % pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise, perfaqesuar sipas Prokure e Pergjithshme Nr.973 Rep, Nr.690 Kol, nga Zj.Marsida Cara

Administratori z. Enea Mitrushi do të mbajë procesverbalin e mbledhjes.

**Pasi u diskutua gjerësisht mbi rendin e ditës, Asambleja e Ortakëve vendosi:**

1- Miratimin e shitjes se Kuotes me 30% pjesemarrje, kuote e cila zoterohet nga ortaku Luçiano Koçeku dhe miratimi I blerjes se kesaj kuote nga pala e trete Shoqerise "Erald – G" shpk
2- Autorizohet Z. Enea Mitrushi me dokument identifikimi Nr. I50823030K per kryerjen e te gjithe procedures prane QKB, nepermjet platformes e-albania per regjistrimin e ketij Vendimi dhe Kontrates se Shitjes se Kuotes, deri ne pasqyrimin perfundimtar te tyre, duke perfshire edhe nenshkrimin elektronik per keto aplikime edhe ne regjistrin e pronareve perfitues.

Pasi u sigurua se nuk ka më çështje për diskutim, mbledhja mbyllet dhe vendimi nënshkruhet në 3 kopje identike dhe shoqerohet me procesverbalin e mbledhjes.

ORTAKET

Marsida Cara

Luçiano KOÇEKU
Perfaqesuar nga Marsida Cara

KUJTIM SHTUFI

Kujtim SHTUFI

NIPT: L 42117004 B
LTD Co
Sh.p.k.
TIRANE - ALBANIA

**PROCES VERBAL**

**I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE ORTAKEVE TE SHOQERISE**

Sot, më date 20.12.2023, në selinë e Shoqërisë "LTD" shpk, me ortake, Z.Kujtim Shtufi dhe Z. Luciano Koceku dhe me administrator Z. Enea Mitrushi, e regjistruar në organet tatimore dhe QKB me NUIS L42117004B, me seli në Rr. "Kajo Karafili", Pallati Mc Inerte, Kati i Dytë, Tiranë, në mbështetje të Statutit dhe Aktit të Themelimit të Shoqerisë, bazuar ne Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqeritë Tregtare", u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme ku te pranishem ishin:

- **Ortaku Kujtim Shtufi** – zotërues i nje kuote me 70 % pjesemarrje ne kapitalin e shoqërisë
- Marsida Cara perfaqesuese sipas Prokure e Pergjithshme Nr.973 Rep, Nr.690 Kol e **Ortakut Luçiano Koçeku** – zotërues i nje kuote me 30 % pjesemarrje ne kapitalin e shoqërisë.

Asambleja verifikon dokumentacionin perkates dhe konstaton se te gjithe ortaket jane njoftuar e kane marre dijeni rregullisht, ata jane prezent personalisht dhe nepermjet perfaqesimitt. Ne keto kushte vendimet e marra nga kjo Asamble do te konsiderohen te vlefshme e te ligjshme.

Enea Mitrushi, zgjidhet mbajtes i procesverbalit

Me qellim qe te shqyrtohet rendi I dites si me poshte:

1. Miratimi i shitjes se Kuotes me 30% pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise "LTD" shpk, kuote e cila zoterohet nga ortaku Luçiano Koçeku dhe miratimi i blerjes se kesaj kuote nga pala e trete Shoqeria "Erald – G" shpk
2. Aprovimin per regjistrimin ne Qendren Kombetare te Biznesit te ketij vendimi
3. Te ndryshme.

**PIKA E PARE E RENDIT TE DITES: 1.- Miratimi i shitjes se Kuotes me 30% pjesemarrje, kuote e cila zoterohet nga ortaku Luçiano Koçeku dhe miratimi i blerjes se kesaj kuote nga Shoqeria "Erald – G" shpk, ne vleren prej 31,479,533 Leke**

Merr fjalen Z. Enea Mitrushi i cili se pari konfirmon njoftimet perkatese dhe ben me dije se ortaket kane marre dijeni per mbledhjen dhe per rendin e dites, duke legjitimuar dhe pjesemarrjen e ortakut Luçiano Koçeku nepermjet perfaqesueses se tij Zj.Marsida Cara. Ne keto kushte eshte e drejte qe te vazhdohet kjo mbledhje.

Ortaku Luçiano Koǯeku ka kerkuar thirrjen dhe mbajtjen e kesaj mbledhje pikerisht per te miratuar transaksionin per shitjen e kuotes qe ai zoteron. Z. Kujtim Shtufi ne vijim te njoftimit per ushtrimin e te drejtes se parablerjes, konfirmon vullnetin e tij per te mos e ushtruar kete te drejte duke dhene pelqimin per shitjen e kuotes nga ana e Z.Luçiano Koçeku tek nje pale e trete, blerese.

Ne perfundim te ketj transaksioni ortaku Kujtim Shtufi do te zoteroje nje kuote me 70% pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise ndersa ortaku Luçiano Koçeku do te largohet nga shoqeria.

**Asambleja mori vendimin e meposhtem:**

**VENDIM 1**
**ME UNANIMITET**

**Miratohet shitja e Kuotes me 30% pjesemarrje, kuote e cila zoterohet nga ortaku Luçiano Koçeku dhe miratimi i blerjes se kesaj kuote nga pala e trete Shoqeria "Erald – G" shpk**

* * * * * * * * * * * * * * * * * *

**PIKA E DYTE E RENDIT TE DITES: 2.- Aprovimin per regjistrimin ne Qendren Kombetare te Biznesit te ketij vendimi.**

Bazuar ne aktivitetin e shoqerise administratori Z. Enea Mitrushi eshte personi pergjegjes per te rregjistruar kete akt sipas parashikimeve dhe per te ndjekur cdo procedure te domosdoshme prane organeve dhe institucioneve shteterore dhe private.

**Asambleja mori vendimin e meposhtem:**

**VENDIM 2**

**ME UNANIMITET**

Miratohet autorizimi i Z. Enea Mitrushi me dokument identifikimi Nr.I50823030K për depozitimin e këtij vendimi dhe cdo akti tjeter deri ne realizimin dhe pasqyrimin perfundimtar në QKB te transaksionit te shitjes.

* * * * * * * * * * * * * * * * * *

**PIKA E TRETE E RENDIT TE DITES : 3.- Te ndryshme.**

Per kete pike asambleja nuk mori vendim pasi ishin diskutime normale mbi aktivitetin e shoqerise, largimin e ortakut dhe aktet qe duhet te hartohen per largimin e tij si dhe mundesite per vijimesine e biznesit.

Mbledhja e Asamblese te Ortakeve, e dites se marte, date 20.12.2023, konsiderohet e mbyllur.

Ky dokument I lexohet paleve, te cilet konstatojne se shpreh vullnetin e tyre te lire dhe se pasqyron gjithcka qe eshte shprehur dhe dakorduar ne mbledhje, duke nenshkruar kete Proces Verbal ne 2 fletet e tij, ne 3 kopje.

Ky proces verbal shoqerohet nga dokumenti Vendim i Asamblese se Pergjitshme te ortakeve.

**ORTAKET PJESEMARRES NE MBLEDHJE**

**Luçiano KOÇEKU**

**Perfaqesuar nga Marsida CARA**

Marsida Cara

**Kujtim SHTUFI**

KUJTIM SHTUFI

Prezent administratori
Enea MITRUSHI

Enea Mitrushi

NIPT: L 42117004 B
LTD Co Sh.p.k.
TIRANE - ALBANIA

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

| | | |
|---|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | K36306784K | |
| 2. Data e Regjistrimit | 16/07/2003 | |
| 3. Emri i Subjektit | ERALD-G | |
| 4. Forma ligjore | SHPK | |
| 5. Data e themelimit | 10/06/2006 | |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 10/06/200610/06/2026 | |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Diber Peshkopi Herbel,Ndertesa private Nr.61 | |
| 8. Kapitali | 122.100.000,00 | |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 1,00 | |
| 9. Objekti i aktivitetit | Projektim, mbikqyrje dhe kolaudim ne fushen e ndertimeve dhe vleresim te pasurive te paluajtshme.Veprimtari ekspertize lidhur me ndikimin në mjedis dhe auditim mjedisor.Studim dhe pergatitja e projekteve mbi masat e mbrojtjes nga zjarri te ndertesave te cdo lloj. Hartimi i akteve te ekspertizes per zjarret e rena.Sherbime te planifikimt urban. Përgatitje dhe hartim të dokumentave të vlerësimit të rrezikut, shërbime për sigurinë dhe shëndetin në punë, në fushën e ndërtimeve dhe të shërbimeve. Zhvillimi i planeve të sigurisë, koordinimit, të ndihmës së parë dhe evakuimit. | |
| 10. Administratori/ët | Gezim Islami | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 01/10/2019 | Deri: 30/09/2024 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 12. Administratori/ët | Eraldo Islami | |
| 12.1 Afati i emërimit | Nga: 05/01/2021 | Deri: 04/01/2026 |
| 13. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 13.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 14. Ortakët | GezimIslami | |
| 14.1 Vlera e kapitalit | Para: 122.100.000,00 | Natyre: |

Kopje nga web

| | |
|---|---|
| 14.2 Numri i pjesëve<br>14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 1,00<br>100,00 |
| *- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)* | |
| 15. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | |
| 16. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: ERALD-G<br>E-Mail: gislami68@yahoo.com<br>Telefon: +35542357970 0682090392 0682090392 |
| 17. Statusi: | Aktiv |

Datë: 21/12/2023

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga web

# EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

## GJENDJA E REGJISTRIMIT

Kopje nga web

| | |
|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS) | L42117004B |
| 2. Data e Regjistrimit | 17/09/2014 |
| 3. Emri i Subjektit | LTD Co |
| 4. Forma ligjore | SHPK |
| 5. Data e themelimit | 13/09/2014 |
| 6. Kohëzgjatja | Nga: 13/09/2014 |
| 7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri | Tirane Tirane TIRANE Njësia Bashkiake Nr. 10, Rruga "Kajo Karafili", Zona Kadastrale 8380. |
| 8. Kapitali | 27.000.000,00 |
| 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave | 3,00 |
| 9. Objekti i aktivitetit | Ne fushen e projektimit dhe te ndertimit: kat. 1 /e- planvendosje e objekteve te veçanta, kat. 2/a, projektime dhe ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore etj. Deri ne dy kate dhe kompletimin me instalimet e nevojshme per to, b- projektime dhe ndertime civile industriale, turistike, bujqesore etj. Dhe kompletimin e instalimeve te nevojshme per to; d- Projektim peizazhi (sistemime, lulishte, vepra arti, dekori etj.) e- projektim interieri, mobile, pajisjes, dizajn industrial. Ne fushen e ndertimit per zbatim: punime dhu, sistemime, tarracime, prodhim elementesh te parafabrikuara betoni e betonarmeje dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore etj. Dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to, punime elektrike, linja TL, TU, impiante elektrike, telefoni, citofoni, dhe mirembajtja e tyre, ndertim rruge, kat. V, VI ndertime rruge kat. Ill, II, I, ndertim fusha aviacioni, veshje asfaltobeton te rrugeve (ndertim mbishtrese) si dhe sistemim e asfaltim sheshe, ndertim vepra arti rrugore dhe hekurudhore, ndertime ujesjellesa dhe kanalizime, sillosa, kulla, kulla uji. Pre betonarmeje dhe metalike, punime karpentjerie metalike, shpime pusesh gjeologjike inxhinjerike dhe hidrogjeologjike, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, nivelime topografike, punime topogjeodezike, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash. Nivelime topografike, punime |

| | | |
|---|---|---|
| | topogjeodezike, punime siperfaqe te gjelberta parqe, lulishte, instalimi i impianteve ngritese dhe transportuese (ashensore etj.)instalimi i impianteve te ngrohjes dhe ftohjes, instalimi i impianteve higjenike, instalimi i impianteve nenpresion, restaurimi i ndertesave monument kulture, punime restaurimi i ndertesave monument kulture, punime restaurimi ne vepra arkeologjike, ndertime gazsjellese, naftesjellese, ndertime diga, galeri, tunele, punime mbrojtje te sistemimit hidraulik-cimentime, kanale dhe impiante vaditje, punime karpentiere druri dhe metali, instalimet dhe impianteve nenpresion, instalimet per nenstacionet, kabinat e transformatoreve. Prodhim, import -export beton, beton armeje dhe cdo nenproduktit te tij, interte etj. Organizimi i transportit te udhetareve dhe te mallrave me mjete te komunikacionit ajror, tokesor dhe detar, çelja e zyrave te agjencive turistike dhe te shitjes se biletave per udhetime brenda dhe jashte vendit me te gjitha llojet e mjeteve, organizimin e sherbimeve, ndihme juridike, kurse profesionale per gjuhe te huaja, kompjuter dhe sekretari, shitje kancelari. Ne fushen e tregtise import - eksporti, me shumice dhe pakice, te mallrave industriale, ushqimore, bujqesor dhe blegtorale, veshmbathje, konfeksione, prodhime e tregtim te materialeve te ndertimit, inerte, rere, zhavorr, automjeteve, makinerive, pajisjeve hidrosanitare, mobileve, artikujve kozmetike, lendeve te perpunuara dhe te paperpunuara , e bimeve medicinave, te lendeve drusore, plastike, duraluminit, tregtim me pakice te karburanteve dhe vajrave lubrifikante. Ne fusha te tjera: hapjen e bar bufeve, restoranteve, pikave te servisit, parkim automjetesh, lavazhit, hoteleve, fshatrave turistik, moteleve si dhe agjencive per shitblerje, dhenie me qira te pasurive te tundshme dhe te patundshem, agjencive per shitblerje, agjenci komisioneve, agjenci transporti, transport te udhetareve dhe te mallrave si brenda vendit ashtu dhe jashte tij. | |
| 10. Administratori/ët | Luçiano Koçeku | |
| 10.1 Afati i emërimit | Nga: 10/04/2018 | Deri: 10/04/2023 |
| 11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore<br>11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | Luçiano Koçeku do të jetë administrator dhe përgjegjës i vetëm i aktivitetit Bar-Restorant. Nenshkrimi sebashku apo vec e vec nga administratori ekzistues Kujtim Shtufi, i Kontratave te Shitjes (sj pale blerese dhe shitese) Kontratave te Furnzimit, Kontrata Sherbimesh dhe Kontratave/ Akt Marreveshje etj, vetem per nje afat 6 mujor. Ne perfundim te afatit 6 mujor, qe fillon ne daten e marrjes se ketij Vendimi, Luciano Koceku do te kete vetem kompetencat aktuale duke | |

Kopje nga web

| | | |
|---|---|---|
| | u zhveshur nga kompetencat e caktuara me kete Vendim. | |
| 12. Administratori/ët | Kujtim Shtufi | |
| 12.1 Afati i emërimit | Nga: 29/04/2020 | Deri: 29/04/2025 |
| 13. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 13.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | | |
| 14. Administratori/ët | Enea Mitrushi | |
| 14.1 Afati i emërimit | Nga: 02/05/2023 | Deri: 01/05/2028 |
| 15. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore | | |
| 15.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka) | Te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te shoqerise, sebashku apo vec e vec nga administratoret ekzistues Kujtim Shtufi dhe Luciano Koceku, duke zbatuar politikat tregtare, statutin dhe ligjin shqiptar ne fuqi, ta perfaqesoje ate ne te gjitha marredheniet qe ajo ngre perfshire nenshkrimin e akteve te ndryshme etj, duke perjashtuar (kufizuar) te drejten e tij per nenshkruar kontrata kredie, kontrata huaje/huaperdorje apo cdo lloj veprimi bankar. | |
| 16. Eksperti/ët Kontabël (nëse ka) | SOKOL TOSKA | |
| 16.1 Afati i emërimit | Nga: 19/01/2023 | Deri: 19/01/2024 |
| 17. Ortakët | LuçianoKoçeku | |
| 17.1 Vlera e kapitalit | Para: 8.100.000,00 | Natyre: |
| 17.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 17.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 30,00 | |
| *- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)* | | |
| 18. Ortakët | KujtimShtufi | |
| 18.1 Vlera e kapitalit | Para: 18.900.000,00 | Natyre: |
| 18.2 Numri i pjesëve | 1,00 | |
| 18.3 Pjesëmarrja në përqindje (%) | 70,00 | |
| *- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)* | | |
| 19. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | Tirane Tirane TIRANE "Godinë Polifunskionale 13 kate mbi tokë me 3 kate nëntokë, me vendndodhje Rr. "Mine Peza", Bashkia Tiranë". Tirane Tirane TIRANE Godine Banimi, Sherbimi dhe Hoteleri 1-4 dhe 8-16 kate nentoke, me vendndodhje ne Rrugen "Dritan Hoxha", Tirane. 1001 | |
| 20. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: LTD Co<br>E-Mail: ltdnova@yahoo.com a.gjini@novagroup.al | |

Kopje nga web

| | |
|---|---|
| | Telefon: 0692350989 0694035390 |
| 21. Statusi: | Aktiv |

Datë: 21/12/2023

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga web